

LIGJI Nr. 06/L-033

PËR PRODUKTE TË NDËRTIMIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR PRODUKTE TË NDËRTIMIT

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë ligj përcaktohen kushtet për vendosjen apo vënien në dispozicion në treg të produkteve të ndërtimit duke përcaktuar rregulla se si të deklarohet performanca, natyra dhe përshtatshmëria e produkteve ndërtimore në lidhje me karakteristikat e tyre themelore dhe/apo përshtatshmërinë për përdorim në punimet ndërtimore.

2. Ky ligj përcakton tri mënyra me të cilat produkti mund të tregoj përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji, si në vijim:

2.1. përdorimi i shenjës CE - shënjimi CE aplikohet atëherë kur vendi i destinacionit të produktit e kërkon një gjë të tillë, por mund të aplikohet edhe për produktet në tregun e Kosovës;

2.2. përdorimi i shenjës së konformitetit të Kosovës aplikohet në rastet kur prodhuesi përmbush kërkesat për vendosjen e saj, të përcaktuara në këtë ligj, apo shenjën tjetër ekuivalente të konformitetit sipas marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare;

2.3. vendosja në tregun e Kosovës së produkteve ndërtimore duke zbatuar dispozita tjera përveç atyre të kërkuara për shenjën CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës.

3. Ky ligj është i bazuar në dispozitat përkatëse të Rregullores së Parlamentit Evropian Nr.305/2011/EU e cila përcakton kushtet për vendosjen në dispozicion të tregut të produkteve të ndërtimit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për produktet e ndërtimit të cilat i plotësojnë kërkesat themelore për punimet e ndërtimit të përcaktuara me nenin 4 të këtij ligji.

2. Vendosja në treg, distribuimi dhe përdorimi i produkteve ndërtimore nuk mund të kufizohet nëse i plotësojnë kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet e miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij ligji, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1. **Produkt i ndërtimit** - çdo produkt apo kit i cili prodhohet dhe vendoset në treg me qëllim të inkomporimit në mënyrë të përhershme në punimet ndërtimore apo pjesë të tyre, performanca e të cilave ndikon në performancën e punimeve ndërtimore sa i përket kërkesave themelore për punimet ndërtimore;

1.2. **Kit** - një produkt ndërtimor i vendosur në treg nga një prodhues i vetëm si një set i së paku dy komponentëve të ndara që duhet të bashkohen në mënyrë që të inkomporohen në punimet e ndërtimit;

1.3. **Punime ndërtimore** - ndërtimet e objekteve dhe punët e inxhinierisë ndërtimore;

1.4. **Karakteristika themelore** - karakteristikat e produktit të ndërtimit të cilat kanë të bëjnë me kërkesat themelore për punimet e ndërtimit;

1.5. **Performanca e një produkti ndërtimor** - performanca e cila ka të bëjë me karakteristikat themelore relevante, të shprehura me nivel ose klasë, apo me një përshkrim;

1.6. **Nivel** - rezultati i vlerësimit të performancës të një produkti të ndërtimit në lidhje me karakteristikat e themelore të tij, të shprehura në vlerë numerike.

1.7. **Klasë** - një sërë nivelesh të performancës së një produkti të ndërtimit, e përkufizuar nga një vlerë minimale dhe maksimale;

1.8. **Niveli i pragut** - nivelin minimal ose maksimal të performancës për një karakteristikë themelore të një produkti të ndërtimit;

1.9. **Tipi i produktit** - grupi i niveleve performances apo klasave përfaqësuese të një produkti të ndërtimit, që kanë të bëjnë me karakteristikat themelore të prodhuar duke përdorur një kombinim të caktuar të lëndëve të para apo elementeve të tjera në një proces të veçantë të prodhimit;

1.10. **Specifikimi teknik i harmonizuar** - standardet e harmonizuara, Dokumentet Evropiane të Vlerësimit (EAD) dhe Dokumentet Kosovare të Vlerësimit (DKV);

1.11. **Standardi i harmonizuar evropian** - standardi i miratuar nga një prej trupave evropiane të standardizimit në bazë të kërkesës së lëshuar nga Komisioni Evropian;

1.12. **Standardi i harmonizuar i Kosovës** - standardi i cili përmbush dispozitat e këtij ligji e që transponon një standard të harmonizuar evropian dhe të njohur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës (MTI);

1.13. **Dokumenti Evropian i Vlerësimit** - dokumenti i miratuar nga organizata e Trupave të Vlerësimit Teknik (TAB)/(EOTA) në Bashkimin Evropian me qëllim të lëshimit të një Vlerësimi Teknik Evropian;

- 1.14. **Vlerësimi Teknik Evropian** - vlerësimi i dokumentuar i performancës së një produkti të ndërtimit, në lidhje me karakteristikat e tij themelore në përputhje me Dokumentin Evropian të Vlerësimit përkatës;
- 1.15. **Qëllimi i përdorimit** - qëllimi i përdorimit të produktit të ndërtimit siç përcaktohet në specifikimet teknike të harmonizuara që zbatohen;
- 1.16. **Dokumentacioni i specifikimit teknik** - dokumentacioni që demonstroi se metodat brenda sistemit që aplikohet për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës janë zëvendësuar me metoda të tjera, me kusht që rezultatet e fituara nga këto metoda të tjera janë ekuivalente me rezultatet e arritura nga metodat e testimit të standardit të harmonizuar përkatës;
- 1.17. **Vënia në dispozicion të tregut** - çdo furnizimin me një produkt të ndërtimit për shpërndarje apo përdorim në tregun e Kosovës në rrjedhën e një veprimtarie tregtare, qoftë me pagesë apo pa pagesë;
- 1.18. **Vendosja në treg** - vënia në dispozicion për herë të parë të një produkti ndërtimi në tregun e të Kosovës;
- 1.19. **Operator ekonomik** - prodhuesi, importuesi, distributori apo përfaqësuesi i autorizuar;
- 1.20. **Prodhues** - çdo person fizik apo juridik i cili prodhon një produkt ndërtimi ose e dizajnon apo prodhon një produkt dhe e vendos në treg atë produkt me emrin apo markën tregtare të tij;
- 1.21. **Distributor** - çdo person fizik apo juridik në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, i cili e vendos në dispozicion të tregut një produkt ndërtimi;
- 1.22. **Importues** - çdo person fizik apo juridik themeluar në Kosovë, i cili e vendos një produkt të ndërtimit nga një vend i huaj në tregun e Kosovës;
- 1.23. **Përfaqësues i autorizuar** - çdo person fizik apo juridik të themeluar në Kosovë, i cili është i autorizuar me shkrim nga një prodhues për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyrat e specifikuar;
- 1.24. **Tërheqje** - çdo masë e cila ka për qëllim parandalimin e një produkti të ndërtimit në zinxhirin e furnizimit që të vendoset në dispozicion të tregut;
- 1.25. **Rikthimi** - çdo masë e cila ka për qëllim kthimin e një produkti të ndërtimit i cili tashmë është vënë në dispozicion për shfrytëzuesin e fundit;
- 1.26. **Akreditim** - vërtetim nga organi shtetëror për akreditim që një trup për vlerësimin e konformitetit i plotëson kërkesat e përcaktuara me standardet e harmonizuara dhe aty ku është e aplikueshme edhe kërkesa të tjera shtesë, përfshirë ato të përcaktuara në skemat relevante sektoriale, për të kryer aktivitete specifike për vlerësimin e konformitetit;
- 1.27. **Kontrolli i prodhimit në fabrikë** - kontrolli i dokumentuar, i përhershëm

dhe i brendshëm i prodhimit në një fabrikë në përputhje me specifikimet teknike të harmonizuara përkatëse;

1.28. **Mikro-ndërmarrje** - një ndërmarrje e cila punëson më pak se dhjetë (10) persona ku qarkullimi vjetor i të cilëve/apo pasqyra e bilancit vjetor të cilëve nuk kalon dy (2) milion Euro;

1.29. **Cikli i jetës** - faza të njëpasnjëshme dhe të ndërlidhura të përdorimit të një produkti të ndërtimit, nga përvetësimi i lëndës së parë apo gjenerimi nga burimet natyrore deri në asgjësimin përfundimtar.

1.30. **Ministria** - ministria përgjegjëse për çështjet e tregtisë dhe industrisë.

Neni 4

Kërkesat themelore për punimet e ndërtimit dhe karakteristikat themelore të produkteve ndërtimore

1. Kërkesat themelore për punimet e ndërtimit duhet që të rregullohen me akt nënligjor nga Ministria brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Këto kërkesa themelore do të përbëjnë bazën për përgatitjen e specifikimeve teknike të harmonizuara.

2. Karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit do të përcaktohen në specifikimet teknike të harmonizuara në lidhje me kërkesat themelore për punimet e ndërtimit.

3. Për llojet specifike të produkteve ndërtimore të mbuluara nga një standard i harmonizuar, Komisioni Evropian, aty ku është e nevojshme dhe në lidhje me qëllimin e përdorimit, ashtu siç janë përkufizuar në standardet e harmonizuara, përmes akteve të deleguara përcakton karakteristikat themelore për të cilat prodhuesi duhet të deklaroj performancën e produktit kur ai të vendoset në treg.

4. Në rastet kur është e nevojshme, Komisioni Evropian përmes akteve të deleguara përcakton nivelet e pragut për performancën në lidhje me karakteristikat themelore që duhet të deklarohen.

5. Aty ku është e përshtatshme për tregun e Kosovës, Ministria do të publikon aktet e deleguara të Komisionit Evropian që ndërlidhen me karakteristikat themelore dhe nivelet e pragjeve, në përputhje me dispozitat e nenit 50 të këtij ligji. Gjithashtu, Ministria mund të publikoj aktet publike të deleguara që nuk ndërlidhen me aktet e deleguara të Komisionit Evropian, në përputhje me dispozitat e nenit 51 të këtij ligji.

KAPITULLI II

DEKLARATA E PERFORMANCËS, SHENJA “CE” DHE SHENJA KONFORMITETIT TË KOSOVËS

Neni 5

Deklarata e Performancës

1. Kur një produkt i ndërtimit mbulohet nga një standard i harmonizuar kosovar dhe evropian apo është konform vlerësimeve teknike evropiane ose vlerësimeve teknike të Kosovës të cilat janë lëshuar për atë produkt, prodhuesi duhet të harton deklaratën të performancës me rastin e

vendosjes në treg të një produkti të tillë.

2. Kur një produkt ndërtimi mbulohet nga një standard i harmonizuar apo është konform vlerësimit teknik evropian apo vlerësimit teknik i Kosovës i cili është lëshuar për atë produkt, çdo informatë për performancën e tij në lidhje me kërkesat themelore siç përkufizohen në specifikimet e harmonizuara teknike, mund të parashihet vetëm nëse janë të përfshira dhe të specifikuara në deklaratën e performancës, përveç kur në përputhje me nenin 6 të këtij ligji nuk është hartuar asnjë deklaratë e performancës.

3. Me hartimin e deklaratës së performancës, prodhuesi merr përgjegjësinë për konformitetin e produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar. Në mungesë të indikacioneve objektive që tregojnë të kundërtën, autoritetet e Kosovës prezumojnë deklaratën e performancës të hartuar nga prodhuesi si të saktë dhe të besueshme.

Neni 6

Përgjashtimet nga obligimi për hartimin e Deklaratës së Performancës

1. Përmes përgjashtimit nga obligimi i nenit 5 paragrafi 1 të këtij ligji dhe në mungesë të dispozitave të Bashkimit Evropian apo dispozitave kombëtare që kërkojnë deklarimin e karakteristikave themelore aty ku produktet e ndërtimit synohen të përdoren, prodhuesi mund të shmanget nga hartimi i deklaratës së performancës gjatë vendosjes në treg të një produkti ndërtimor të mbuluar nga një standard i harmonizuar ku:

1.1. produkti i ndërtimit është prodhuar në mënyrë individuale ose me porosi në një proces jo-serik në përgjigje të një porosie specifike, dhe është instaluar në një punim ndërtimi të vetëm, nga një prodhues i cili është përgjegjës për inkorporimin e sigurt të produktit në punimet të ndërtimit, në përputhje me rregullat kombëtare të zbatueshme dhe nën përgjegjësinë e atyre që janë përgjegjës për ekzekutimin e sigurt të punimeve ndërtimore të përcaktuara në rregullat e zbatueshme kombëtare;

1.2. produkti i ndërtimit është prodhuar në vendpunishte për inkorporimin e tij në punimet e caktuara të ndërtimit në përputhje me rregullat kombëtare të zbatueshme dhe nën përgjegjësinë e atyre që janë përgjegjës për ekzekutimin e sigurt të punimeve ndërtimore të përcaktuara në rregullat e zbatueshme kombëtare; apo

1.3. produkti i ndërtimit është prodhuar në mënyrë tradicionale ose në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen e trashëgimisë dhe në një proces jo-industrial për mënyrën adekuate për renovim të punimeve të ndërtimit të mbrojtura zyrtarisht si pjesë e një mjedisi të caktuar apo për shkak të vlerave të tyre të veçanta arkitektonike apo historike, në përputhje me rregullat e zbatueshme kombëtare.

Neni 7

Përmbajtja e deklaratës së performancës

1. Deklarata e performancës duhet të shpreh performancën e produkteve të ndërtimit në raport me karakteristikat themelore të atyre produkteve në pajtim me specifikimet teknike përkatëse të harmonizuara.

2. Deklarata e performancës duhet të përmbanë në veçanti të dhënat e mëposhtme për:

2.1. referencën e tipit të produktit për të cilin është hartuar deklarata e performancës;

2.2. sistemin ose sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës së produktit të ndërtimit;

2.3. numrin e referencës dhe datën e lëshimit/publikimit të standardit të harmonizuar kosovar dhe evropian ose vlerësimit teknik evropian apo vlerësimit teknik të Kosovës që është përdorur për vlerësimin e çdo karakteristike themelore;

2.4. kur është e mundur, numrin e referencës së dokumentacionit teknik specifik të përdorur dhe kërkesat me të cilat prodhuesi deklaron se produkti është konform tyre.

3. Deklarata e performancës, duhet të përmbajë edhe:

3.1. qëllimin e përdorimit për produktin e ndërtimit, në përputhje me specifikimet teknike të aplikueshme të harmonizuara;

3.2. listën e karakteristikave themelore, të përcaktuara në specifikimet teknike të harmonizuara për qëllimin e deklaruar për përdorim;

3.3. performancën e të paktën një prej karakteristikave themelore të produktit të ndërtimit për qëllimin e deklaruar për përdorim. Nëse nuk ekziston obligim për të deklaruar performancën e të paktën një karakteristike themelore për shkak se nuk ka kërkesa rregullative për punime ndërtimore që kërkon karakteristika të tilla, produkti nuk është një "produkt ndërtimit" sipas kuptimit të ligjit dhe për këtë lirohet nga dispozitat e tij;

3.4. kur është e mundur, performancën e produktit të ndërtimit sipas niveleve ose klasave, ose në përshkrim nëse është e nevojshme në bazë të llogaritjeve në lidhje me karakteristikat e tij themelore të përcaktuara me nenin 4 paragrafi 3 të këtij ligji;

3.5. performancën e karakteristikave themelore të produktit të ndërtimit të cilat janë të ndërlidhura me përdorimin apo qëllimin e përdorimit, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me përdorimin apo qëllimin e përdorimit aty ku prodhuesi synon të vendos produktin në dispozicion të tregut;

3.6. për karakteristikat themelore të listuara për të cilat nuk është deklaruar performanca, shënohet "NDP" (Nuk Deklarohet Performanca);

3.7. kur për atë produkt është lëshuar vlerësimi teknik Evropian apo vlerësimi teknik i Kosovës, performanca me nivele apo klasa në një përshkrim të produktit ndërtimor në lidhje me të gjitha karakteristikat themelore që përmban vlerësimi përkatës teknik Evropian apo të Kosovës.

4. Deklarata e performancës hartohet duke përdorur modelin e përcaktuar me akt nënligjor, të miratuar nga Ministria.

5. Për produktet e vendosura në treg në Bashkimin Evropian, informatat në lidhje me përmbajtjen dhe/ose lirimin e substancave të rrezikshme duhet të sigurohen së bashku me deklaratën e performancës. Për produktet e vendosura në tregun e Kosovës, informatat në lidhje me përmbajtjen dhe/ose lirimin e substancave të rrezikshme duhet të jepet së bashku me deklaratën e performancës në përputhje me të gjitha kërkesat rregullatore të aplikueshme në Kosovë.

Neni 8

Ofrimi i deklaratës së performancës

1. Kopja e deklaratës së performancës për secilin produkt të vënë në dispozicion në treg duhet të ofrohet në letër ose formë elektronike.
2. Megjithatë, kur një grumbull i produktit të njëjtë i është furnizuar një përdoruesi të vetëm, ai mund të shoqërohet me një kopje të vetme të deklaratës së performancës në formë të letrës ose në formë elektronike.
3. Kopja e shkruar e deklaratës së performancës ofrohet në bazë të kërkesës së pranuesit.
4. Përmes shmangies nga paragrafi 1 dhe 3 të këtij neni, kopja e deklaratës së performancës mund të jetë në dispozicion në ueb-faqe.
5. Deklarata e performancës duhet të ofrohet në gjuhë apo gjuhët e kërkuara nga shteti ku produkti është vendos në dispozicion të tregut.
6. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet për deklarimin e performancës së produktit të ndërtimit.

Neni 9

Parimet e përgjithshme dhe përdorimi i shenjës CE

1. Për vendosjen e shenjës CE zbatohen parimet e përgjithshme të përcaktuara në rregullat specifike për shënjimimin e konformitetit.
2. Shenja CE, duhet të vendoset në ato produkte të ndërtimit për të cilat prodhuesi ka hartuar Deklaratën e Performancës në përputhje me nenet 5 dhe 7 të këtij ligji duke zbatuar një standard të harmonizuar evropian apo një dokument evropian të vlerësimit.
3. Nëse deklarata e Performancës nuk është hartuar nga prodhuesi në përputhje me nenet 5 dhe 7 të këtij ligji, atëherë shenja CE nuk lejohet të vendoset.
4. Me vendosjen e shenjës CE, prodhuesi merr përgjegjësi për konformitetin të produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar, si dhe përputhjen me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në Legjislacionin e Bashkimit Evropian për Produktet e Ndërtimit dhe në legjislacionin tjetër të harmonizuar të Bashkimit Evropian të cilat e përcaktojnë vendosjen e saj.
5. Rregullat për vendosjen e shenjës CE të parapara në legjislacionin tjetër të harmonizuar të Bashkimit Evropian zbatohen pa cenuar paragrafin 4 të këtij neni.
6. Për çdo produkt të ndërtimit të mbuluar nga një standard i harmonizuar evropian apo për të cilin është bërë vlerësimi teknik evropian, shenja CE është shenja e vetme që vërteton konformitetin e produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar në lidhje me karakteristikat themelore të përcaktuara me atë standard të harmonizuar apo atë Vlerësim Teknik Evropian.

Neni 10

Parimet e përgjithshme dhe përdorimi i shenjës së konformitetit të Kosovës

1. Parimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren për shenjen e konformitetit, do të zbatohen për vendosjen e shenjës së konformitetit të Kosovës. Përdorimi i shenjës së konformitetit të Kosovës mbetet opsional, përveç nëse një vendim i marrë nga Ministria, në përputhje me nenin 51 të këtij ligji e bën të detyrueshme.
2. Shenja e konformitetit të Kosovës mund të vendoset vetëm në ato produkte ndërtimore për të cilat prodhuesi ka hartuar një deklaratë të performancës në përputhje me nenet 5 dhe 7 të këtij ligji duke aplikuar një standard kosovar të harmonizuar ose dokument vlerësimi të Kosovës.
3. Kriteret në lidhje me kërkesat themelore, vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës, deklaratën e performancës dhe shenjën CE janë ato të dhëna në Shtojcën ZA (ose Shtojcën Z) të standardit evropian të harmonizuar të miratuar. Në rastet kur zbatohen standardet kosovare për qëllime të vendosjes së shenjës së konformitetit të Kosovës, shprehjet në shtojcë që kanë të bëjnë me vendosjen e shenjës CE (në veçanti por pa u kufizuar në “trupat e notifikuar” dhe “shenja CE”) zëvendësohen me shprehje kosovare (“trupat e emëruara”, “shenja e konformitetit të Kosovës”).
4. Nëse nuk është hartuar deklarata e performancës nga prodhuesi në përputhje me nenet 5 dhe 7 të këtij ligji, shenja e konformitetit të Kosovës nuk lejohet të vendoset.
5. Duke vendosur shenjen e konformitetit të Kosovës, prodhuesi merr përgjegjësin për konformitetin e produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar, si dhe përputhshmërinë me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në këtë ligj në lidhje me vendosjen e shenjës së konformitetit të Kosovës dhe në akte të tjera përkatëse të Kosovës që përcaktojnë vendosjen e tyre.
6. Rregullat për vendosjen e shenjës së konformitetit të Kosovës të parapara në akte të tjera përkatëse të Kosovës zbatohen pa cenuar paragrafin 5 të këtij neni.
7. Për çdo produkt të ndërtimit të mbuluar nga një standard i harmonizuar kosovar apo për të cilat është bërë vlerësimi teknik kosovar, shenja e konformitetit të Kosovës është shenja e vetme që vërteton konformitetin e produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar në lidhje me karakteristikat themelore të mbuluara me atë standard të harmonizuar apo atë vlerësim teknik kosovar.
8. Ministria përmes autoritetetve kompetente për mbikëqyrjen e tregut nuk e ndalon apo pengon vënien në dispozicion në treg apo përdorimin e produkteve të ndërtimit që bartin shenjën e konformitetit të Kosovës, kur performancat e deklaruara përputhen me kërkesat për përdorimin e tillë në Kosovë.
9. Ministria përmes autoritetetve kompetente për mbikëqyrjen e tregut siguron që përdorimi i produkteve të ndërtimit që bartin shenjën e konformitetit të Kosovës nuk do të pengohet me anë të rregullave ose kushteve shtesë të vëna nga organet publike apo organet private që veprojnë si ndërmarrje publike apo që veprojnë si organ publik në bazë të një pozite monopoli apo me mandat publik, në rast se performancat e deklaruara përputhen me kërkesat për përdorimin e tillë në Kosovë.

10. Metodatat e përdorura në Kosovë në lidhje me kërkesat për punimet e ndërtimit, si dhe rregullat e tjera kombëtare në lidhje me karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit duhet të jenë në përputhje me standardet e harmonizuara kosovare.

Neni 11

Rregullat dhe kushtet për vendosjen e shenjës CE apo shenjës së konformitetit të Kosovës

1. Shenja CE ose shenja e konformitetit të Kosovës, duhet të vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme në produktin e ndërtimit ose në etiketë të bashkangjitur në atë produkt. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk garantohej për shkak të natyrës së produktit, ajo vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese.

2. Shenja CE ose shenja e konformitetit të Kosovës duhet të shoqërohet nga dy shifrat e fundit të vitit në të cilin ajo është vendosur për herë të parë, emri dhe adresa e prodhuesit të regjistruar ose shenja identifikuese që lejon identifikim me lehtësi të emrit dhe adresës së prodhuesit dhe pa dykuptimësi, kodin unik të identifikimit të llojit të produktit, numrin e referencës së deklaratës së performancës, nivelin apo klasën e performancës së deklaruar, referencën për specifikimet teknike të zbatuara, numrin e identifikimit të trupit të emëruar (për shenjën e konformitetit të Kosovës) ose trupit të notifikuar (për shenjën CE), nëse është e aplikueshme dhe qëllimi i përdorimit siç është përcaktuar në specifikimet e harmonizuara teknike të zbatuara.

3. Shenja CE apo shenja e konformitetit të Kosovës duhet të vendoset para vendosjes së produktit të ndërtimit në treg. Kjo mund të shoqërohet nga ndonjë piktogram ose ndonjë shenjë tjetër që në veçanti tregon rrezik ose përdorim të veçantë.

Neni 12

Rregullat dhe kushtet për tregtimin e produkteve të ndërtimit që nuk bartin shenjën CE ose shenjën e konformitetit të Kosovës

1. Produktet e ndërtimit që vendosen në tregun e Kosovës, konformiteti i të cilave me dispozitat e këtij ligji nuk dëshmohej me anë të shenjës CE ose shenjës së konformitetit të Kosovës, duhet t'i përmbush dispozitat e nenit 55 të këtij ligji.

2. Produktet e mbuluara në paragrafin 1 të këtij neni nuk duhet të bartin shenjat rregullative të konformitetit CE ose shenjën e konformitetit të Kosovës.

Neni 13

Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit

1. Ministria me vendim e cakton pikën e kontaktit për produktet e ndërtimit.

2. Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit me kërkesë "ndër të tjera" të një operatori ekonomik apo autoriteti kompetent të një shteti tjetër, ofron informatat e mëposhtme për:

2.1. rregullat teknike të zbatueshme për lloje të caktuara produkteve të ndërtimit në Kosovë dhe informata nëse ai lloj produkti i nënshtrohet kërkesës për autorizim paraprak sipas ligjeve të Kosovës, bashkë me informatat në lidhje me parimin e njohjes reciproke dhe zbatimin e këtij ligji në territorin e Kosovës;

2.2. të dhënat kontaktuese të autoriteteve kompetente brenda Kosovës, përmes të cilave ata mund të kontaktohen drejtpërdrejtë, duke përfshirë të dhënat e veçanta për autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimit të rregullave teknike në fjalë në territorin e Kosovës;

2.3. mjetet juridike që janë të dispozicion në përgjithësi në Kosovë në rast të kontesteve ndërmjet autoriteteve kompetente dhe një operatori ekonomik.

3. Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit do të përgjigjet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas pranimit të një kërkesë të referuar në paragrafin 2 të këtij neni.

4. Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit në Kosovë, ku operatori ekonomik e ka tregtuar në mënyrë të ligjshme produktin e ndërtimit, duhet t'i ofrojë operatorit ekonomik ose autoritetit kompetent informatat relevante ose vrojtimit.

5. Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit nuk do ngarkon tarifa për ofrimin e informatave të referuara në paragrafin 2 të këtij neni.

6. Sa i përket detyrave të përkufizuara në paragrafin 2 të këtij neni, Ministria garanton që pika e kontaktit për produktet e ndërtimit ofron informata duke përdorur terme transparente dhe lehtësisht të kuptueshme mbi dispozitat ligjore brenda Kosovës që për përbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit, të zbatueshme për përdorimin e destinuar të çdo produkti të ndërtimit, siç parashihet në nenin 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të këtij ligji.

7. Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit duhet të kryejë funksionet/detyrat e saj në mënyrë të tillë që shmang konfliktin e interesit, veçanërisht në lidhje me procedurat për marrjen e shenjës CE ose shenjës së konformitetit të Kosovës.

KAPITULLI III DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIK

Neni 14 Detyrimet e prodhuesve

1. Prodhuesit duhet të hartojnë deklaratën e performancës në përputhje me nenet 5 dhe 7 të këtij ligji dhe të vendosin shenjën CE ose shenjën e konformitetit të Kosovës në përputhje me nenet 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji, ose duhet të ofrojnë informatat në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

2. Prodhuesit si bazë për deklaratën e performancës në mbështetje të shenjës CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës, hartojnë dokumentacionin teknik që përshkruan të gjitha elementet përkatëse në lidhje me sistemin e kërkuar të vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës.

3. Prodhuesit duhet të ruajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e performancës për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh pasi që produkti i ndërtimit të jetë vendosur në treg.

4. Kur është e përshtatshme, Ministria mundet që me anë të akteve të deleguara në përputhje me nenin 50 të këtij ligji të ndryshojë atë periudhë për grupet e produkteve të ndërtimit në bazë

të jetëgjatësisë së parashikuar apo rolit të atij produkti të ndërtimit në punimet e ndërtimit.

5. Prodhuesit duhet të sigurojnë se janë vendos procedurat për të siguruar që prodhimi serik i përmbahet performancës së deklaruar. Ndryshimet në tipin e produktit si dhe në specifikimet e harmonizuara teknike të zbatueshme do të merren parasysh në mënyrë adekuate.

6. Prodhuesit duhet që kur konsiderohet e nevojshme duke marr parasysh sigurimin e saktësisë, besueshmërisë, qëndrueshmërisë të performancës së deklaruar të një produkti ndërtimi, të kryejnë testimin e mostrave për produktet e ndërtimit të vendosura në dispozicion të tregut, të hetojnë dhe nëse është e nevojshme, të mbajnë një regjistër të ankesave për produktet jo-konforme dhe të rikthimit të produkteve si dhe të mbajnë të informuar distributorët për çdo monitorim të tillë.

7. Prodhuesit duhet të sigurojnë se produktet e tyre të ndërtimit mbajnë tipin, shenjën ose numrin serik ose çdo element tjetër që mundëson identifikimin e tyre, apo kur madhësia ose natyra e produktit nuk e lejon atë, të sigurohet se informacionet e kërkuara të jenë të shënjuara në paketim ose në një dokument që shoqëron produktin e ndërtimit.

8. Prodhuesit duhet të shënojnë në produktin e ndërtimit, emrin e tyre, emrin e biznesit të regjistruar apo markën tregtare të tij dhe adresën e kontaktit ose kur kjo nuk është e mundur këto të dhëna shënohen në paketimin e tij ose në dokumentin shoqërues të tij. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme kontaktuese të prodhuesit.

9. Kur prodhuesit e vendosin një produkt ndërtimi në dispozicion të tregut, duhet të sigurojnë që produkti është i shoqëruar me udhëzimet dhe informacionet për sigurinë të cilat duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Kosovës.

10. Prodhuesit të cilët konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar se një produkt ndërtimi të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me deklaratën e performancës ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj, duhet menjëherë të ndër marrin masa korigjuese për të sjellë produktin e ndërtimit në përputhje me kërkesat ligjore, ose të tërheqin apo të rikthejnë atë. Kur produkti paraqet rrezik, prodhuesi duhet informojë menjëherë autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut të vendit në të cilin ai produkt i ndërtimit është vënë në dispozicion të tregut, duke dhënë detaje, në veçanti të mos përputhshmërisë dhe të ndonjë mase korigjuese.

11. Prodhuesit duhet që me kërkesë të arsyetuar nga autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e tregut, të shoqërojnë produktin e ndërtimit me të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar përputhshmërinë e tij me deklaratën e performancës dhe kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji të cilat duhet të jenë në gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga ai autoritet. Ata duhet të bashkëpunojnë me atë autoritet në saje të kërkesës, për çfarëdo mase të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga produkti i ndërtimit të cilin e kanë vendosur në treg.

Neni 15

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Prodhuesi mund t'a emërojë me mandat të shkruar një përfaqësues të autorizuar.

2. Hartimi i dokumentacionit teknik nuk është përgjegjësi e përfaqësuesit të autorizuar gjatë mandatit të tij.

3. Përfaqësuesi i autorizuar duhet të kryej detyrat e përcaktuara me mandat. Mandati i lejon përfaqësuesit të autorizuar që të kryej të paktën detyrat e mëposhtme:

3.1. të mbaj deklaratën e performancës dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kompetente për mbikëqyrjen e tregut për afatin kohor të përcaktuar në nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji;

3.2. me kërkesë të arsyetuar nga autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut, ia ofron atij autoriteti të gjitha informatat dhe dokumentet e nevojshme për të dëshmuar konformitetin e produktit të ndërtimit me deklaratën e performancës dhe përputhshmërinë me kërkesa të tjera të zbatueshme sipas këtij ligji;

3.3. të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut sipas kërkesës së tyre, për çfarëdo veprimi të ndërmarrë me qëllim të eliminimit të rrezikut që paraqesin produktet e ndërtimit të cilat mbulohen në mandatin e përfaqësuesit të autorizuar.

4. Për produktet e vendosura në tregun e Bashkimit Evropian (BE), përfaqësuesi i autorizuar është i regjistruar në BE. Për produktet e vendosura në tregun e Kosovës, përfaqësuesi i autorizuar është i regjistruar në Kosovë.

Neni 16

Detyrimet e importuesve

1. Importuesit duhet të vendosin në tregun e Kosovës vetëm produkte të ndërtimit të cilat janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Para vendosjes në treg të produktit të ndërtimit, importuesi duhet të siguron që vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës (për produktet që bartin shenjën CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës) apo procedurat e tjera relevante të vlerësimit (për produktet e tjera të ndërtimit) është kryer nga prodhuesi. Importuesi duhet të siguron që prodhuesi ka hartuar dokumentacionin teknik të referuar në nenin 14 paragrafi 2, dhe deklaratën e performancës në përputhje me nenet 5 dhe 7 të këtij ligji (për produktet që bartin shenjën CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës). Importuesi gjithashtu do të sigurohet se produkti, aty ku është e nevojshme, mban shenjën CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës, dhe që produkti është i shoqëruar me dokumentet e nevojshme dhe se prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 14 paragrafët 7 dhe 8 të këtij ligji.

3. Kur importuesi konsideron ose ka arsye për të besuar se produkti i ndërtimit nuk është në përputhje me deklaratën e performancës ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të përcaktuara me këtë ligj, ai nuk e lejon të vendoset produkti i ndërtimit në treg deri sa produkti të përputhet me deklaratën e performancës dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme të përcaktuara me këtë ligj, ose derisa të korrigohet deklarata e performancës. Kur produkti i ndërtimit paraqet rrezik, importuesi duhet të informojë prodhuesin dhe autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut.

4. Importuesit duhet të shënjojnë, emrin e tyre, emrin e markës së regjistruar ose markën tregtare dhe adresën e tyre të kontaktit në produktin e ndërtimit, ose kur kjo nuk është e mundur, në paketimin e tij ose në dokumentet shoqëruese.

5. Kur një produkt ndërtimi vendoset në dispozicion në treg, importuesi duhet të sigurojë që produkti shoqërohet me udhëzuesit dhe informacionet për sigurinë në gjuhën zyrtare.

6. Importuesit duhet të sigurojnë që derisa produkti i ndërtimit është nën përgjegjësinë tij, kushtet e deponimit dhe transportit nuk e rrezikojnë konformitetin e tij me deklaratën e performancës dhe në pajtim me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji.

7. Importuesit duhet që, kur konsiderohet e nevojshme duke marr parasysh sigurimin e saktësisë, besueshmërisë, qëndrueshmërisë së performancës të deklaruar të një produkti ndërtimi, të kryejnë testimin e mostrave të produkteve të ndërtimit të vendosura në dispozicion të tregut, të hetojnë dhe nëse është e nevojshme, të mbajnë një regjistër të ankesave për produktet jokonforme dhe produktet e kthyer, si dhe të mbajnë distributorët e informuar për çdo monitorim.

8. Importuesit të cilët e konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar se një produkt ndërtimi të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me deklaratën e performancës ose me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji, duhet menjëherë të ndërmarrin masa korrigjuese për të sjellë produktin e ndërtimit në konformitet, ose nëse është e nevojshme, të tërheqin apo të rikthejnë atë. Kur produkti paraqet rrezik, importuesi duhet informon menjëherë autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut, duke dhënë detaje, në veçanti për mos përputhshmërinë dhe ndonjë mase korrigjuese të ndërmarrë.

9. Importuesit duhet që për periudhën e përcaktuar në nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji, të mbajnë një kopje të deklaratës së performancës në dispozicion të autoritetit të mbikëqyrjes së tregut dhe të sigurojnë që dokumentacioni teknik është vënë në dispozicion të këtyre autoriteteve sipas kërkesës.

10. Importuesit duhet që pas kërkesës të arsyetuar nga autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e tregut, të ofrojnë të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar përputhshmërinë e produktit të ndërtimit me deklaratën e performancës dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji në një gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga ai autoritet. Importuesit duhet të bashkëpunojnë me atë autoritet në bazë të kërkesës, për çfarëdo mase të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që shkaktohen nga produkti i ndërtimit të cilin ata e kanë vendosur në treg.

Neni 17

Detyrimet e distributorëve

1. Kur një produkt i ndërtimit vendoset në dispozicion të tregut, distributorët duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e përcaktuara të këtij ligji.

2. Para vendosjes në treg të produktit të ndërtimit, distributorët duhet të sigurojnë që produkti i tillë mban shenjimin CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës kur kërkohet, shoqërohet nga dokumentet e kërkuara sipas këtij ligji, me udhëzimet dhe me informacionet e sigurisë në gjuhën zyrtare. Distributorët duhet gjithashtu të sigurojnë që prodhuesi dhe importuesi kane vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 paragrafi 7 dhe 8 dhe nenin 16 paragrafi 4 të këtij ligji.

3. Kur një distributor konsideron ose ka arsye të besojë se produkti i ndërtimit nuk është në përputhje me deklaratën e performancës ose me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji, distributori nuk mund të vendos në dispozicion në treg produktin deri sa të përputhet me deklaratën e performancës dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji ose derisa të korrigjohet deklarata e performancës. Kur produkti i ndërtimit paraqet rrezik, distributorët duhet të informojnë prodhuesin, importuesin dhe autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut.

4. Distributori duhet të siguron që përderisa produkti i ndërtimit është nën përgjegjësinë tij, kushtet e deponimit apo të transportit nuk e rrezikojnë konformitetin e tij me deklaratën e performancës dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji.

5. Distributorët të cilët e konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar se një produkt ndërtimi të cilin e kanë vendosë në dispozicion në treg nuk është në përputhje me deklaratën e performancës ose me kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji, ata duhet të sigurohen që janë ndërmarrë masa korrigjuese për të sjellë produktin e ndërtimit në përputhje, ose nëse është e nevojshme, të tërheqin apo të rikthejnë atë produkt. Kur produkti paraqet rrezik, distributorët duhet informojnë autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë detaje, në veçanti të mos përputhshmërisë dhe të ndonjë mase korrigjuese të marrë.

6. Distributorët duhet që pas kërkesës të arsyetuar nga autoriteti kompetent për mbikëqyrjen së tregut, t'i ofrojnë këtij autoriteti të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar konformitetin e produktit të ndërtimit me deklaratën e performancës dhe kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji, të cilat duhet të jenë në gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga ai autoritet. Distributorët duhet të bashkëpunojnë me atë autoritet në bazë të kërkesës për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga produkti i ndërtimit të cilin e kanë vendosë në dispozicion në treg.

Neni 18

Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesve zbatohen për importuesit dhe distributorët

Importuesi apo distributori konsiderohet si prodhues nëse përmbush detyrimet e prodhuesit në përputhje me këtë ligj dhe do t'i nënshtrohet obligimeve të prodhuesit të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, kur ai vendos një produkt ndërtimi në treg me emrin apo markën e tij tregtare apo nëse e modifikon produktin e ndërtimit tashmë të vendosur në treg në mënyrë të tillë që mund të ndikohet përputhshmëria me deklaratën e performancës apo të ndikohet ndonjë dëshmi tjetër e konformitetit.

Neni 19

Identifikimi i operatorëve ekonomik

1. Për periudhën e përcaktuar në nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji, operatorët ekonomik duhet që sipas kërkesës se autoriteteve për mbikëqyrje të tregut, të identifikojnë si në vijim:

1.1. çdo operator ekonomik i cili i ka furnizuar ata me produkte ndërtimi;

1.2. çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me produkte ndërtimi.

KAPITULLI IV

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE HARMONIZUARA

Neni 20

Standardet e harmonizuara evropiane

1. Standardet e harmonizuara evropiane janë përgatitur nga njëri prej trupave evropiane të standardizimit në bazë të kërkesave (këtu e tutje 'mandatet') e lëshuara nga Komisioni Evropian.

2. Komisioni Evropian publikon në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian listën e referencave të standardeve të harmonizuara të cilat janë në përputhje me mandatet përkatëse.

3. Për çdo standard të harmonizuar në listë jepen informatat e mëposhtme:

3.1. referencat e specifikimeve të harmonizuara teknike të zëvendësuara, nëse ka;

3.2. data e fillimit të periudhës së bashkë-ekzistencës;

3.3. data e përfundimit të periudhës së bashkë-ekzistencës.

4. Komisioni Evropian publikon çdo azhurnim të asaj liste.

Neni 21

Standardet e harmonizuara të Kosovës

1. Standardet e harmonizuara të Kosovës miratohen nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), në bazë të standardeve të harmonizuara evropiane, referencat ndaj të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

2. Agjencia Kosovare e Standardizimit miraton standardet e nevojshme mbështetëse që kërkohen nga standardet e harmonizuara, por që këto standarde nuk do të konsiderohen si të harmonizuara.

3. Agjencia Kosovare e Standardizimit i prezanton Ministrisë standardet potenciale të harmonizuara të Kosovës për miratim. Nëse Ministria i pranon standardet si të tilla që i përmbushin të gjitha dispozitat e këtij ligji, ajo e publikon listën e referencave ndaj këtyre standardeve në mënyrë të përshtatshme.

4. Për çdo standard të harmonizuar të Kosovës në listë jepen informatat e mëposhtme:

4.1. referencat e specifikimeve të harmonizuara teknike të zëvendësuara, nëse ka;

4.2. data e fillimit të periudhës së bashkë-ekzistencës;

4.3. data e përfundimit të periudhës së bashkë-ekzistencës.

5. Ministria publikon çdo azhurnim të asaj liste.

Neni 22

Zbatimi i standardeve të harmonizuara

1. Nga data e fillimit të periudhës së bashkë-ekzistencës duhet të jetë e mundur të përdoret një standard i harmonizuar për të hartuar deklaratën e performancës për një produkt ndërtimi të mbuluar nga ai standard.

2. Pa paragjykuar nenet 26, 27 dhe 28 të këtij ligji nga data e përfundimit të periudhës së bashkë-ekzistencës, standardi i harmonizuar do të jetë mjeti i vetëm që përdoret për hartimin e deklaratës së performancës për një produkt ndërtimi të mbuluar nga ai standard.

3. Në fund të periudhës së bashkë-ekzistencës, të gjitha standardet kombëtare që janë në kundërshtim do të tërhiqen dhe Ministria shfuqizon të gjitha dispozitat kombëtare që janë në kundërshtim.

Neni 23

Dokumenti evropian ose kosovar i vlerësimit

1. Prodhuesit kosovar mund të bëjnë kërkesë për Vlerësim Teknik Evropian tek Trupi i Vlerësimit Teknik i vendosur në ndonjë shtet anëtarë të Bashkimit Evropian për çfarëdo produkti ndërtimor që nuk mbulohet ose nuk mbulohet plotësisht nga standardi i harmonizuar, për të cilin performanca në lidhje me karakteristikat e tij themelore nuk mund të vlerësohet tërësisht në përputhje me ndonjë standard ekzistues të harmonizuar, sepse, *ndër të tjera*:

1.1. produkti nuk është në kuadër të fushëveprimit të ndonjë standardi ekzistues të harmonizuar;

1.2. metoda e vlerësimit e parashikuar në standardin e harmonizuar nuk është adekuate për të paktën një karakteristikë themelore të atij produkti; ose

1.3. standardi i harmonizuar nuk parasheh ndonjë metodë të vlerësimit në lidhje me të paktën një karakteristikë themelore të atij produkti.

2. Procedura për hartimin e Dokumentit Evropian të Vlerësimit si përgjigje ndaj një kërkesë për vlerësim teknik evropian është përcaktuar sipas Legjislacionit të Bashkimit Evropian për Produktet e Ndërtimit.

3. Nëse kushtet e bëjnë të përshtatshme dhe të dëshirueshme, Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet sipas të cilave prodhuesi mund të bëjë kërkesë për Vlerësimin Teknik Kosovar. Ky akt nënligjor do të përcaktojë obligimet dhe dispozitat për themelimin e Trupit për Vlerësim Teknik në Kosovë, së bashku me procedurat për hartimin e Dokumenteve kosovare të Vlerësimit të dhe Vlerësimeve Teknike Kosovare.

Neni 24

Nivelet ose klasat e performancës

1. Ministria mund të miratojë akte të deleguara në pajtim me nenin 50 të këtij ligji, për të vendosur klasa të performancës në raport me karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit.

2. Në rastet kur Ministria ka krijuar klasa të performancës në lidhje me karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit, Agjencia e Kosovare e Standardizimit i përdor ato klasa në standardet e kosovare të harmonizuara. Në rastet kur klasat e performancës në lidhje me karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit nuk vendosen nga Ministria, ato mund të vendosen nga ana e Agjencisë Kosovare të Standardizimit në standarde të harmonizuara në bazë të kërkesës nga Ministria.

3. Në rastet kur është e përcaktuar në kërkesën e Ministrisë, Agjencia e Kosovare e Standardizimit do vendos në standardet e harmonizuara nivelet e pragut në lidhje me karakteristikat themelore dhe kur është e nevojshme përdorimet e destinuara, që duhet të plotësohen nga produktet e ndërtimit në Kosovë.

4. Ministria mund të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 50 të këtij ligji, për të përcaktuar kushtet sipas të cilave një produkt i ndërtimit do të konsiderohet se i përmbush

nivelet apo klasën e caktuar të performancës pa e testuar apo pa e testuar të më tutje. Në rast se kushte të tilla nuk janë mundësuar nga Ministria, ato mund të përcaktohen nga Agjencia e Kosovare e Standardizimit në standardet e kosovare të harmonizuara.

5. Kur standardet e harmonizuara përmbajnë sisteme klasifikimi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Ministria mund të përcaktojë nivelet ose klasat e performancës që duhen respektuar nga produktet e ndërtimit në lidhje me karakteristikat e tyre themelore vetëm në përputhje me ato sisteme klasifikimi.

6. Agjencia e Kosovare e Standardizimit duhet t'u përmbahet nevojave rregullative të Kosovës gjatë përcaktimit të niveleve apo klasave të lejuara të performancës.

7. Kur aktet e deleguara të Komisionit Evropian përcaktojnë klasat e performancës dhe/ose nivelet e pragut, këto klasa dhe/ose nivele janë detyruese për produktet e tregtuara në Bashkimin Evropian ose në zonën ekonomike Evropiane, pa marrë parasysh nëse gjenden apo jo në standardet evropiane të harmonizuara.

Neni 25

Vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës

1. Vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit në lidhje me karakteristikat themelore të tyre do të bëhet në përputhje me njërin nga sistemet e përcaktuara me akt nënligjor nga Ministria.

2. Me akte nënligjore në pajtim me nenin 50 të këtij ligji, Ministria do të miratoj ose krijoj dhe mund të rishikojë, duke marrë veçanërisht parasysh ndikimin në shëndetin dhe sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit, se cili sistem apo cilat sisteme janë të zbatueshme për një produkt të caktuar të ndërtimit ose grupe të produkteve të ndërtimit apo për një karakteristikë themelore të caktuar. Ministria gjithashtu do të merr parasysh sistemin apo sistemet e themeluara me vendimet e Komisionit Evropian (dhe të përfshira në standardet e harmonizuara evropiane apo në Dokumente Evropiane të Vlerësimit) dhe përvojat e dokumentuara nga autoritetet kombëtare në lidhje me mbikëqyrjen e tregut.

3. Ministria zgjedh sistemin ose sistemet më lehtë të zbatueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave themelore për punimet ndërtimore.

4. Sistemi apo sistemet e përcaktuara në këtë mënyrë specifikohen në kërkesat për standardet e harmonizuara të Kosovës dhe specifikimet teknike të harmonizuara të Kosovës.

KAPITULLI V

PROCEDURAT E THJESHTUARA

Neni 26

Përdorimi i dokumentacionit të duhur teknik

1. Në përcaktimin e tipit të produktit, prodhuesi mund ta zëvendësojë testimin e tipit ose përlogaritjen e tipit me dokumentacionin e duhur teknik duke demonstruar se:

1.1. për një ose disa karakteristika themelore të produktit të ndërtimit, të cilin prodhuesi

e vendos në treg, produkti konsiderohet se ka arritur një nivel ose klasë të caktuar të performancës pa u testuar apo përlogaritur, ose pa testim ose përlogaritje të mëtejme, në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet përkatëse të harmonizuara teknike, në vendimin e Komisionit Evropian apo të Ministrisë;

1.2. produkti ndërtimor i cili mbulohet nga një standard i harmonizuar, të cilin prodhuesi e vendos në treg korrespondon me tipin e produktit të një tjetër produkti ndërtimor të prodhuar nga një prodhues tjetër i cili tashmë është testuar në përputhje me standardet e harmonizuara relevante. Pas përmbushjes së këtyre kushteve, prodhuesi ka të drejt të deklaroj performancën që përputhet me të gjitha apo me një pjesë të rezultateve të testit të produktit tjetër. Prodhuesi mund të përdor rezultatet e testit të një prodhuesi tjetër vetëm pasi të ketë marr autorizimin e atij prodhuesi, i cili mbetet përgjegjës për saktësinë, besueshmërinë dhe stabilitetin e këtyre rezultateve të testit; apo

1.3. produkti ndërtimor i cili mbulohet nga një specifikim i harmonizuar teknik, të cilin prodhuesi e vendos në treg është një sistem i përbërë nga komponente, të cilin prodhuesi e monton në mënyrë adekuate duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga ofruesi i një sistemi të tillë apo një komponent i tij, që tashmë e ka testuar sistemin apo atë komponent sa i përket një apo disa prej karakteristikave të tij themelore në përputhje me specifikimet përkatëse teknike të harmonizuara. Pas përmbushjes së këtyre kushteve, prodhuesi ka të drejt të deklaroj performancën që korrespondon me të gjitha apo një pjesë të rezultateve të testit sa i përket sistemit apo komponentës së ofruar nga ai. Prodhuesi mund të përdor rezultatet e një prodhuesi tjetër apo ofruesi të sistemit vetëm pasi të ketë marr autorizimin e atij prodhuesi apo ofruesi të sistemit, i cili mbetet përgjegjës për saktësinë, besueshmërinë dhe stabilitetin e këtyre rezultateve të testit.

2. Nëse produkti i ndërtimit i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i takon një tipi të produkteve të ndërtimit për të cilat sistemi i zbatueshëm për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë të performancës është sistemi 1 + ose 1, i cili përcaktohet me akt nënligjor sipas këtij ligji, Dokumentacioni i duhur teknik i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të verifikohet nga një trup certifikues i notifikuar për produktin (për produktet e vendosura në treg në Bashkimin Evropian) ose nga trupi certifikues i emëruar për produktin (për produktet e vendosura në treg të Kosovës) të përcaktuara me akt nënligjor.

Neni 27

Përdorimi i procedurave të thjeshtuara nga mikro-ndërmarrjet

Mikro-ndërmarrjet prodhuese të produkteve të ndërtimit të mbuluara nga një standard i harmonizuar mund të zëvendësojnë përcaktimin e tipit të produktit në bazë të testimit të tipit për sistemet e aplikueshme 3 dhe 4 i cili përcaktohet me akt nënligjor sipas këtij ligji, duke përdorur metodat e ndryshme nga ato të përfshira në standardin e harmonizuar të zbatueshëm. Ata prodhues gjithashtu mund të trajtojnë produktet e ndërtimit për të cilin zbatohet sistemi 3 në përputhje me dispozitat për sistemin 4. Kur një prodhues i zbaton këto procedura të thjeshtuara, prodhuesi duhet të demonstrojë përputhshmërinë e produktit të ndërtimit me kërkesat e zbatueshme me anë të Dokumentacionit Specifik Teknik dhe do të demonstroj ekuivalencën e procedurave të përdorura me procedurat e përcaktuara në standardet e harmonizuara.

Neni 28

Procedurat e tjera të thjeshtuara

1. Në lidhje me produktet e ndërtimit të mbuluara nga një standard i harmonizuar dhe të cilat janë prodhuar në mënyrë individuale ose me porosi në një proces jo-serik në përgjigje ndaj një porosie të veçantë dhe të cilat instalohen në punime ndërtimi të vetme të identifikuara, ku pjesa

e vlerësimit të performancës të sistemit të aplikueshëm ashtu siç përcaktohet me akt nënligjor në bazë të këtij ligji, mund të zëvendësohet nga prodhuesi me Dokumentacionin Specifik Teknik që demonstroi përputhshmërinë e këtij produkti me kërkesat e zbatueshme dhe ekuivalente mes procedurave të përdorura dhe procedurave të përcaktuara në standardet e harmonizuara.

2. Nëse produkti i ndërtimit i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i takon një lloji të produkteve të ndërtimit për të cilat sistemi i zbatueshëm për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë të performancës është sistemi 1 + ose 1, siç përcaktohet me akt nënligjor sipas këtij ligji, Dokumentacioni specifik teknik do të verifikohet nga një trup certifikues i notifikuar për produktin (për produktet e vendosura në treg në Bashkimin Evropian) ose nga një trup i emëruar certifikues për produktin (për produktet e vendosura në treg të Kosovës), ashtu siç përcaktohet me akt nënligjor sipas këtij ligji.

KAPITULLI VI AUTORITETI EMËRUES DHE TRUPAT E EMËRUARA

Neni 29 Emërimi

Ministria do të publikojë listën të këtyre trupave të cilat i emëron për kryer detyrat e palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës në bazë të këtij ligji (në vijim referuar si “trupat e emëruara”).

Neni 30 Autoriteti emërues

1. Ministria do të jetë autoriteti emërues përgjegjës për vendosjen dhe kryerjen e procedurave të nevojshme për vlerësimin dhe emërimin e trupave që do të jenë të emëruar që të kryejnë detyrat e palëve të treta në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës për qëllime të këtij ligji, si dhe për monitorimin e trupave të emëruara, duke përfshirë përputhshmërinë e tyre sipas nenit 33 të këtij ligji.

2. Ministria mund të vendos që vlerësimi dhe monitorimi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DAK).

3. Nëse Ministria delegon ose i beson vlerësimin, emërimin ose monitorimin e përcaktuar në paragrafin 1, një trupi që nuk është entitet qeveritar, ai trup do të jetë një entitet/person juridik dhe duhet të jenë në përputhje *mutatis mutandis* me kërkesat e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji. Duhet të ketë marrëveshje që të mbulojë detyrimet që dalin nga aktivitetet e tij.

4. Ministria do të marrë përgjegjësinë e plotë për detyrat e kryera nga trupi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 31 Kërkesat në lidhje me autoritetet emëruese

1. Ministria si autoritet emërues, ose trupi të cilit i janë deleguar përgjegjësit emëruese do të veprojnë në mënyrë të tillë që mos të ketë konflikte të interesit me trupat e emëruara.

2. Autoriteti emërues do të organizohet dhe funksionoj në atë mënyrë që të ruajë objektivitetin dhe paanshmërinë e aktiviteteve të saj.
3. Autoriteti emërues duhet të organizohet në mënyrë të tillë që çdo vendim në lidhje me emërimin e trupave që do të kryejnë detyrat e palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës është marrë nga persona kompetentë të ndryshëm nga ata që kryejnë vlerësimin.
4. Autoriteti emërues nuk do të ofroj apo të siguroj aktivitete që kryhen nga trupat e emëruara, apo të ofroj shërbime të konsulencës në baza komerciale apo konkurruese.
5. Autoriteti emërues do të ruajë konfidencialitetin e informacionit të marrë.
6. Autoriteti emërues do të ketë një numër të mjaftueshëm të personelit kompetent në dispozicion për kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të duhur.

Neni 32

Mundësitë e informimit për Kosovën

Ministria mund të informoj Komisionin Evropian për procedurat e saj kombëtare për vlerësimin dhe emërimin e trupave të emëruara që do të kryejnë detyra të palëve të treta në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës dhe monitorimin e trupave të emëruara dhe çdo ndryshim të saj. Ministria mund të informojë edhe vendet e tjera gjithashtu.

Neni 33

Kërkesat për trupat e emëruara

1. Për qëllim të emërimit, një trup i emëruar duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 deri 16 të këtij neni.
2. Trupi i emëruar duhet të themelohet sipas ligjeve kombëtare dhe duhet të jetë person juridik.
3. Trupi i emëruar duhet të jetë një trup si palë e tretë, i pavarur nga organizata ose produkti i ndërtimit të cilin e vlerëson.
4. Një trup që i takon një shoqate biznesi apo një organizate profesionale që përfaqëson ndërmarrjet e përfshira në dizajnimin, prodhimin, ofrimin, montimin, përdorimin apo mirëmbajtjen e produkteve ndërtimore të cilat i vlerëson mund të konsiderohet si një trup i tillë më kusht që mund të demonstrohet pavarësia e tij dhe mos ekzistimi i konfliktit të interesit.
5. Një trup i emëruar, menaxhmenti i tij i lartë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës, nuk duhet të jenë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i produkteve të ndërtimit të cilat i vlerëson, e as përfaqësuesi i autorizuar i ndonjë prej këtyre palëve. Kjo nuk përjashton përdorimin e produkteve të vlerësuara që janë të nevojshme për veprimtarinë e trupit të emëruar ose përdorimin e produkteve për qëllime personale.
6. Një trup i emëruar, menaxhmenti i tij i lartë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës

nuk duhet të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në projektimin, prodhimin ose ndërtimin, furnizimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e atyre produkteve të ndërtimit, e as të mos i përfaqësoj palët në këto aktivitete. Ata nuk do të angazhohen në ndonjë aktivitet që mund jetë në konflikt me pavarësinë e tyre të gjykimit dhe integritetin në lidhje me aktivitetet për të cilat ata janë emëruar. Kjo në veçanti do të vlejë për shërbimet e konsulencës.

7. Trupi i emëruar duhet të sigurojë që aktivitetet e filialeve të tij ose nën-kontraktorëve nuk ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin dhe paanshmërinë e aktiviteteve të vlerësimit dhe / ose të verifikimit.

8. Trupi i emëruar dhe personeli i tij do të kryejnë detyrat e palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës së nevojshme teknike në fushën specifike dhe duhet të jenë të lirë nga çdo presion dhe nxitje, veçanërisht financiare të cilat mund të ndikojnë në gjykimin e tyre ose në rezultatet e vlerësimit të tyre dhe/ose aktiviteteve verifikuese, veçanërisht nga persona ose grupe personash me interes në rezultatet e këtyre veprimtarive.

9. Trupi i emëruar duhet të jetë i gatshëm të kryejë të gjitha detyrat e palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës për të cilat është emëruar, përcaktohen me akt nënligjor sipas këtij ligji, pavarësisht nëse ato detyra kryhen nga vetë trupi i emëruar ose në emër dhe nën përgjegjësinë e tij.

10. Trupi i emëruar, në çdo kohë dhe për çdo sistem të vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës dhe për çdo tip apo kategori të produkteve të ndërtimit, për karakteristikat themelore dhe detyrat për të cilat është i emëruar, duhet të ketë në dispozicion si vijon:

10.1. personelin e nevojshëm me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe adekuate për kryerjen e detyrave të palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës;

10.2. përshkrimin e nevojshëm të procedurave sipas të cilave është kryer vlerësimi i performancës, duke siguruar transparencën dhe mundësinë e përsëritjes të këtyre procedurave; duhet të ketë politika dhe procedura të duhura që e bëjnë dallimin mes të detyrave që kryen si një trup i emëruar dhe aktivitete të tjera;

10.3. procedurat e nevojshme për të kryer aktivitetet e tij të cilat marrin parasysh madhësinë e një ndërmarrje, sektorin në të cilin funksionin, strukturën, shkallën e kompleksitetit të produkteve teknologjike në fjalë si dhe masën apo natyrën serike të procesit të prodhimit.

11. Trupi i emëruar duhet të ketë mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrave teknike dhe administrative si duhet në lidhje me aktivitetet për të cilat është emëruar dhe duhet të ketë qasje tek të gjitha pajisjet dhe objektet e nevojshme.

12. Personeli përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve për të cilat është emëruar trupi duhet të ketë si vijon:

12.1. përgatitje profesionale dhe teknike të duhur që mbulon të gjitha detyrat e palëve të treta në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës në kuadër të fushëveprimit relevant për të cilin trupi është emëruar;

12.2. njohuri të mjaftueshme mbi kërkesat e vlerësimeve dhe verifikimeve të cilat ata i

kryejnë si dhe kompetencë për të kryer aktivitete të tilla;

12.3. njohuri të përshtatshme dhe të kuptuarit për standardet e harmonizuara të zbatueshme dhe dispozitave relevante të këtij ligji;

12.4. aftësia e nevojshme për hartimin e certifikatave, regjistrave dhe raporteve për të demonstruar se janë kryer vlerësimet dhe verifikimet.

13. Duhet të sigurohet paanshmëria e trupit të emëruar, menaxhmentit të tij të lartë dhe personelit vlerësues. Kompensimi i menaxhmentit të lartë dhe personelit vlerësues të trupit të emëruar nuk duhet të varet nga numri i vlerësimeve të kryera apo nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

14. Trupi i emëruar duhet të jetë i siguar për përgjegjësinë për dëmin, përveç nëse përgjegjësia merret nga shteti në përputhje me ligjet në fuqi, apo nëse vetë shteti është drejtpërdrejt përgjegjës për vlerësimin dhe/ose verifikimin e kryer.

15. Personeli i trupit të emëruar është i detyruar të respektoj parimin për ruajtjen e sekretit profesional sa i përket informatave të marra gjatë kryerjes së detyrave të përcaktuara me akt nënligjor sipas këtij ligji, përveç në lidhje me autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut dhe Ministrinë. Të drejtat e pronësisë duhet të mbrohen.

16. Trupi i emëruar duhet të marrë pjesë, apo të sigurohet se personeli i tij vlerësues është i informuar në lidhje me aktivitetet relevante të standardizimit dhe aktivitetet e grupit koordinues të trupave të notifikuar të Bashkimit Evropian i cili është themeluar sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian për Produktet e ndërtimit dhe do të shërbej si udhëzues i përgjithshëm për vendimet administrative dhe dokumentet e përgatitura si rezultat i punës së këtij grupi.

Neni 34

Prezumimi i konformitetit

1. Trupi i emëruar i cili do të emërohet për kryerje të detyrave të palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës që dëshmon konformitetin e tij me kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara përkatëse apo në pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, do të prezumohet se i përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, për aq sa standardet e harmonizuara të zbatueshme i mbulojnë këto kërkesa.

2. Autoritetet Kosovare do të prezumojnë që trupat e notifikuara të themeluara në Bashkimin Evropian ose në vende të tjera ku marrëveshjet ndërkombëtare parashohin ekzistencën e trupave të notifikuara i përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, për aq sa standardet e harmonizuara të zbatueshme i mbulojnë ato kërkesa.

Neni 35

Filialet dhe nën-kontraktorët e trupave të emëruara

1. Në rastet kur një trup i emëruar nën-kontraktin detyra specifike që ndërlidhen me detyrat e palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës apo ka lidhje me një filial, ai siguron që nën-kontraktori ose filiali i plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, si dhe e informon autoritetin emërues në lidhje me këtë.

2. Trupi i emëruar mban përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nën-kontraktorët ose filialet pavarësisht prej vendit të themelimit të tyre.
3. Aktivitetet mund të nënkontraktohen apo realizohen nga një filial vetëm me marrëveshjen e klientit.
4. Trupi i emëruar do të mban në dispozicion të autoritetit emërues dokumentet përkatëse lidhur me vlerësimin e kualifikimeve të një nën-kontraktori ose filiali dhe të detyrave të kryera nga këto palë të cilat përcaktohen me akt nënligjor sipas këtij ligji.

Neni 36

Shfrytëzimi i hapësirave jashtë laboratorit testues nga trupi i emëruar

1. Me kërkesë të prodhuesit dhe kur arsyetohet për shkaqe teknike, ekonomike apo logjistike, trupat e emëruara mund të kryejnë testet e përcaktuara me akt nënligjor sipas këtij ligji, për sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës 1+, 1 dhe 3 ose të monitorojnë kryerjen e testeve të tilla qoftë në impiantet prodhuese duke përdorur pajisjet për testim të laboratorit të brendshëm të prodhuesit apo, me pëlqimin paraprak të prodhuesit, në një laborator të jashtëm, duke përdorur pajisjet për testim të atij laboratorit.
2. Trupat e emëruara të cilat kryejnë teste të tilla duhet të jenë specifikisht të përcaktuara si kompetente për të punuar jashtë hapësirave testuese të tyre të akredituara.
3. Para kryerjes së këtyre testeve, trupi i emëruar verifikon nëse janë plotësuar kërkesat e metodës së testimit dhe vlerëson nëse:
 - 3.1. pajisjet e testimit kanë sistemin e duhur të kalibrimit dhe nëse gjurmueshmëria e matjeve është e garantuar;
 - 3.2. është siguruar cilësia e rezultateve të testit.

Neni 37

Aplikimi për emërim

1. Një trup për të qenë i emëruar që të kryejë detyra të palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës, duhet të parashtron kërkesë për emërim tek autoriteti emërues i Kosovës.
2. Kërkesa duhet të shoqërohet me një përshkrim të aktiviteteve që do të kryhen, procedurat e vlerësimit dhe/ose të verifikimit për të cilat trup pretendon të jetë kompetent dhe certifikatën e akreditimit, të lëshuar nga organi kombëtar i akreditimit (DAK), që vërteton se trupi për vlerësimin e konformitetit i plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.

Neni 38

Procedura e emërimit

1. Autoriteti emërues mund të emërojë vetëm trupat të cilat i kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.
2. Autoriteti emërues mund të informojë Komisionin Evropian dhe vendet e tjera për trupat të cilat i emëron sipas kërkesës.

3. Emërimi përmban detaje të plota të detyrave që do të kryhen, referencën ndaj specifikimeve të harmonizuara teknike përkatëse dhe karakteristikat themelore për të cilat është trupi për vlerësimin e konformitetit kompetent, për qëllim të zbatimit të sistemit të përcaktuar me akt nënligjor sipas këtij ligji. Megjithatë, referenca ndaj specifikimit teknik të harmonizuar përkatës nuk është e nevojshme në rastet e emërimit horizontal të përcaktuar me akt nënligjor të këtij ligji.

Neni 39

Numrat e identifikimit dhe lista e trupave të emëruara

1. Ministria i cakton një numër unik të identifikimit çdo trupi të emëruar.
2. Ministria e cakton një numër të vetëm edhe atëherë kur trupi është i emëruar sipas disa akteve të Kosovës.
3. Kur është e mundur, numri do të bëhet në një mënyrë të tillë që mos ketë asnjë konfuzion me trupat e notifikuar të Bashkimit Evropian.
4. Ministria e bën publike listën e trupave të emëruara në bazë të këtij ligji, duke përfshirë edhe numrat e identifikimit të cilët u janë dhënë trupave të emëruara dhe aktivitetet për të cilët ata janë emëruar, me anë të mjeteve të përshtatshme të publikimit.
5. Ministria siguron që kjo listë të mbahet e përditësuar.

Neni 40

Ndryshimet në emërim

1. Në rast se autoriteti emërues konstaton ose është informuar se një trup i emëruar më nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, ose që nuk po arrin të përmbushë obligimet e tij, atëherë autoriteti emërues do të kufizojë, pezullojë ose tërheqë emërimin sipas nevojës, varësisht nga serioziteti i dështimit për të plotësuar këto kërkesa ose për të përmbushur këto obligime. Ai mund të informojë Komisionin Evropian dhe vendet e tjera në lidhje me këtë.
2. Në rast të tërheqjes, kufizimit ose pezullimit të emërimit ose kur trupi i emëruar e ndërpret aktivitetin e tij, autoriteti emërues do të ndërmarrë hapat e duhur për të siguruar që dosjet e këtij trupi të procesohen nga një trup tjetër i emëruar, ose të mbahen në dispozicion të autoritetit emërues dhe të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut sipas kërkesës së tyre.

Neni 41

Dyshimi për kompetencën e trupave të emëruara

1. Autoriteti emërues do të hetoj të gjitha rastet kur dyshon në lidhje me kompetencat e një trupi të emëruar apo në përmbushjen e vazhdueshme të kërkesave dhe përgjegjësive nga ana e një trupi të emëruar.
2. Autoriteti emërues duhet të sigurojë që të gjitha informatat e ndjeshme të marra gjatë hetimeve të trajtohen në mënyrë konfidenciale.
3. Nëse autoriteti emërues konstaton se një trup i emëruar nuk i plotëson, ose nuk vazhdon t'i plotëson edhe më tutje kërkesat për emërimin, ai do të kërkojë nga trupi i emëruar që të ndërmarrë masat e nevojshme korigjuese, por nëse është e nevojshme mund të tërheqë emërimin.

Neni 42

Detyrimet operative të trupave të emëruara

1. Trupat e emëruar i kryejnë detyrat e palës së tretë në përputhje me sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës të cilat përcaktohen me akt nënligjor sipas këtij ligji.
2. Vlerësimet dhe verifikimet e qëndrueshmërisë së performancës duhet të kryhen me transparencë sa i përket prodhuesit dhe në mënyrë proporcionale duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomikë. Trupat e emëruara i kryejnë aktivitetet e tyre duke marrë parasysh madhësinë e ndërmarrjes, sektorin në të cilin operon ndërmarrja, strukturën e saj, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së produktit në fjalë dhe natyrën masive ose serike të procesit të prodhimit.
3. Duke vepruar në këtë mënyrë, trupat e emëruara megjithatë duhet të respektojnë shkallën e rigozitetit që e kërkon ky ligj për produktin dhe rolin që luan produkti për përmbushjen e të gjitha kërkesave themelore relevante për punimet e ndërtimit.
4. Nëse gjatë inspektimit fillestar të impiantit të prodhimit dhe kontrollit të prodhimit në fabrikë, trupi i emëruar konstaton se prodhuesi nuk e ka siguruar qëndrueshmërinë e performancës së produktit të prodhuar, atëherë do të kërkojë nga prodhuesi të ndërmarrë masat e nevojshme korrigjuese dhe nuk do t'i lëshojë certifikatën.
5. Në rast se gjatë aktivitetit të monitorimit me qëllim të verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës së produktit të prodhuar, trupi i emëruar konstaton se produkti i ndërtimit më nuk e ka performancën e njëjtë me atë të tipit të produktit, do të kërkojë nga prodhuesi të ndërmarrë masat e duhura korrigjuese dhe do të pezullojë ose tërheqë certifikatën e tij nëse është e nevojshme.
6. Në rast se nuk janë ndërmarrë masat korrigjuese ose nuk kanë dhënë efektin e caktuar, atëherë sipas nevojës, trupi i emëruar do të kufizojë, pezullojë ose tërheqë certifikatat e lëshuara.

Neni 43

Detyrimet për informim për trupat e emëruara

1. Trupat e emëruara e informojnë autoritetin emërues në lidhje me:
 - 1.1. çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje të certifikatave;
 - 1.2. çdo rrethanë që ndikon në fushëveprimin dhe kushtet e emërimit;
 - 1.3. çdo kërkesë për informim për aktivitetet e kryera të vlerësimit dhe/ose verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës, të cilat i kanë marrë nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut;
 - 1.4. sipas kërkesës, detyrat e palës së tretë në përputhje me sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës të kryera në kuadër të emërimit të tyre dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, duke përfshirë aktivitetet ndërkufitare dhe nënkontraktimet.

2. Trupat e emëruara u ofrojnë trupave të tjera të cilat janë të emëruara në bazë të këtij ligji për kryerjen e detyrave të ngjashme të palës së tretë në përputhje me sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës dhe për produktet e ndërtimit të rregulluara me specifikimet teknike të harmonizuara të njëjta informacionet përkatëse për çështjet që lidhen me rezultatet negative dhe, sipas kërkesës, për rezultatet pozitive nga këto vlerësime dhe/ose verifikime.

Neni 44 **Shkëmbimi i përvojës**

Ministria vendos kontaktin e duhur me organizatat brenda Bashkimit Evropian për organizimin e shkëmbimit të përvojave në mes të Kosovës dhe autoriteteve kombëtare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat janë përgjegjëse për politikën në lidhje me notifikimin.

Neni 45 **Koordinimi i trupave të emëruara dhe të notifikuara**

1. Ministria kujdeset që të sigurojë që trupat e emëruara të Kosovës të kenë qasje në grupin e trupave të notifikuara të Bashkimit Evropian, që trupat e emëruara të kenë të drejtë të marrin pjesë në takimin e grupit dhe që t'u jepet qasje në dokumentet e grupit.

2. Rregullat dhe udhëzimet nga grupi i trupave të notifikuara të Bashkimit Evropian janë detyrimore për trupat e emëruara për qëllime të shënimit të konformitetit të Kosovës, përveç nëse Ministria me vendim të veçantë ndalon zbatimin e një ose më shumë dokumenteve të tilla në Kosovë.

KAPITULLI VII **MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KLAUZOLA MBROJTËSE**

Neni 46

Procedurat e trajtimit në nivel kombëtar të produkteve të ndërtimit që paraqesin rrezik

1. Kur autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në Kosovë kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se një produkt i ndërtimit i mbuluar nga një standard të harmonizuar ose për të cilin është dhënë një vlerësim teknik evropian ose kosovar, nuk arrin performancën e deklaruar dhe paraqet rrezik për përmbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit të rregulluara me këtë ligj, ata duhet të bëjnë një vlerësim në lidhje me produktin në fjalë që përfshinë kërkesat përkatëse të përcaktuara me këtë ligj. Operatorët ekonomik përkatës bashkëpunojnë sipas nevojës me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

2. Kur, gjatë vlerësimit, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konstatojnë se produkti i ndërtimit nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, ata duhet të kërkojnë nga operatori ekonomik përkatës që pa vonesë të ndërmarrë të gjitha masat e duhura korrigjuese për të arritur përputhshmërinë e produktit me këto kërkesa, sidomos me performancën e deklaruar ose që ta tërheqë produktin nga tregu, apo që t'a kthejë atë për një periudhë të arsyeshme, në përputhje me natyrën e rrezikut që ata e përcaktojnë.

3. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut e informojnë në lidhje me këtë trupin e emëruar apo të notifikuar në qoftë se një trup i tillë është i përfshirë.

4. Të gjitha masat që ndërmerren gjatë kryerjes e mbikëqyrjes së tregut në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili është në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkimit Evropian, e me të cilat masa ndalohet ose kufizohet vendosja e produkteve në treg, parandalohet distribuimi i produktit ose produkti tërhiqet nga tregu, duhet të jenë proporcionale dhe të specifikojnë saktë bazën ku ato janë referuar.
5. Operatori ekonomik njoftohet me shkrim për çdo masë të ndërmarrë, si dhe mjetet juridike që janë në dispozicion të tij dhe për afatet e parashtrimit të tyre.
6. Para ndërmarrjes së masave, operatorit ekonomik i mundësohet që të deklarohet në afatin kohor jo më pak se dhjetë (10) ditë, përveç kur kjo nuk është e mundur për shkak të urgjencës në marrjen e masave për të mbrojtur shëndetin ose sigurinë në lidhje me interesat publike të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
7. Nëse masa është ndërmarr dhe operatorit ekonomik nuk i është lejuar që paraprakisht të deklarohet, duhet t'i jepet mundësia e deklarimit sipas legjislacionit në fuqi.
8. Të gjitha masat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, do të ndërpriten ose të ndryshohen pasi që operatori ekonomik ti ketë kryer detyrimet.
9. Kur autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konsiderojnë se mospërputhshmëria nuk kufizohet në territorin e tyre kombëtar, ata mund informojnë Komisionin Evropian dhe vendet e tjera për rezultatet e vlerësimit dhe veprimet që kanë kërkuar të ndërmerren nga operatorit ekonomik.
10. Operatori ekonomik siguron ndërmarrjen e të gjitha masave të duhura korrigjuese në lidhje me të gjitha produktet e ndërtimit në fjalë, të cilat operatorit ekonomik i ka vënë në dispozicion në tregun e Kosovës.
11. Nëse operatorit ekonomik përkatës, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, nuk ndërmerr masat e duhura korrigjuese, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut do të ndërmarrin të gjitha masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar vënien në dispozicion të produktit të ndërtimit në tregun kombëtar ose për ta tërhequr atë nga tregu ose për ta kthyer.
12. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut mund të informojnë pa vonesë Komisionin Evropian dhe shtetet e tjera në lidhje me këto masa.
13. Informacioni i përmendur në paragrafin 11 të këtij neni përfshin të gjitha të dhënat në dispozicion, e në veçanti të dhënat e nevojshme për identifikimin e produktit të ndërtimit që nuk është në përputhje, origjinën e produktit të ndërtimit, natyrën e mospërputhjes së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të ndërmarrja, si dhe argumentet e paraqitura nga operatorit ekonomik përkatës. Në veçanti, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të tregojnë nëse mospërputhja ndodh për arsye të njërit prej shkaqeve të mëposhtme:
- 13.1. dështimi i produktit në arritjen e performancës së deklaruar dhe/ose në përmbushjen e kërkesave në lidhje me plotësimin e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit të përcaktuara në këtë ligj;
- 13.2. mangësitë në specifikimet teknike të harmonizuara apo në Dokumentacionin Specifik Teknik.

Neni 47

Klauzola mbrojtëse

1. Nëse një shtet tjetër, i cili është i informuar në lidhje me masën e ndërmarrë nga Kosova, konsideron se masa e tillë kombëtare është joproporcionale, jo-bindëse ose e pajustificuar, ai mund të hyjë pa vonesë në konsultime me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut të Kosovës dhe të bëjë vlerësimin e masave kombëtare. Në bazë të rezultateve të këtij vlerësimi, në mes të dy palëve arrihet marrëveshja edhe nëse masa është apo nuk është e justifikueshme. Ministria menjëherë e përcjell këtë vendim tek operatorët ekonomikë përkatës.

2. Nëse masa kombëtare konsiderohet si e justifikuar, atëherë Kosova duhet të ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që produkti i ndërtimit i cili nuk ka qenë në përputhje të tërhiqet nga tregu. Nëse masa kombëtare konsiderohet si e pajustificuar, atëherë Kosova e tërheq atë masë.

3. Nëse masa kombëtare konsiderohet të jetë e justifikuar dhe mospërputhshmëria e produktit të ndërtimit i referohet mangësive në standardet e harmonizuara, siç përcaktohet në nenin 46 paragrafi 13, nën paragrafi 13.1 të këtij ligji, Ministria mund të informojë trupin ose trupat përkatëse evropiane të standardizimit në rastin e një standardi të harmonizuar evropian dhe Agjencinë Kosovare të Standardizimit në rastin e një standardi të harmonizuar të Kosovës.

4. Kur masa kombëtare konsiderohet të jetë e justifikuar dhe mospërputhshmëria e produktit të ndërtimit i referohet mangësive në dokumentin evropian të vlerësimit, dokumentin kosovar të vlerësimit ose në dokumentacionin specifik teknik, siç përmendet në nenin 46 paragrafi 13 nën paragrafi 13.2 të këtij ligji, Ministria e informon trupin e vlerësimit teknik (TAB) i cili e ka përgatitur Dokumentin e Vlerësimit, prodhuesin i cili e ka përgatitur Dokumentacionin Teknik Specifik dhe/ose, sipas nevojës, importuesin dhe distributorin.

Neni 48

Përputhshmëria e produkteve të ndërtimit të cilat paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë

1. Kur pas kryerjes së një vlerësimi sipas nenit 46 paragrafi 1 të këtij ligji, autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të Kosovës konstatojnë se edhe pse një produkt i ndërtimit është në përputhshmëri me këtë ligj, ai paraqet rrezik ndaj përmbushjes së kërkesave themelore për punimet e ndërtimit, ndaj shëndetit dhe sigurisë së personave ose ndaj aspekteve të tjera të mbrojtjes së interesit publik, ato kërkojnë që operatori ekonomik përkatës të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që produkti i ndërtimit në fjalë, kur të vendoset në treg, të mos e paraqesë më atë rrezik, të tërheqë produktin e ndërtimit nga tregu, ose ta rikthejë atë për një periudhë të arsyeshme, konform natyrës së rrezikut që mund t'i përcaktojnë.

2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që çdo veprim korrigjues ndërmerret në lidhje me të gjitha produktet e ndërtimit në fjalë të cilat ai operator ekonomik i ka vënë në dispozicion në tregun e Kosovës.

3. Autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të Kosovës menjëherë mund të informojnë Komisionin Evropian dhe shtetet e tjera. Ky informacion përfshin të gjitha të dhënat në dispozicion, e në veçanti të dhënat të cilat janë të nevojshme për identifikimin e produktit të ndërtimit në fjalë, origjinën dhe zinxhirin furnizues të produktit, natyrën e rrezikut të përfshirë, si dhe natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të ndërmarrura kombëtare.

Neni 49**Mospërputhshmëria formale**

1. Pa paragjykuar nenin 46 të këtij ligji, në rastet kur autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të Kosovës konstatojnë njërën nga të gjeturat e mëposhtme, ata duhet të kërkojnë nga operatori ekonomik përkatës t'i japë fund mospërputhshmërisë në fjalë:

1.1. shenja CE është vendosur në kundërshtim me nenin 9 dhe 11 të këtij ligji, ose shenja konformitetit të Kosovës është vendosur në kundërshtim me nenit 10 dhe 11 të këtij ligji;

1.2. shenja CE ose shenja konformitetit të Kosovës nuk është vendosur kur kërkohet, në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 dhe nenin 10 paragrafi 2 të këtij ligji;

1.3. pa paragjykuar nenin 6, deklarata e performancës nuk është hartuar kur kërkohet, në pajtim me nenin 5 të këtij ligji;

1.4. deklarata e performancës nuk është hartuar në pajtim me nenet 5, 7 dhe 8 të këtij ligji;

1.5. dokumentacioni teknik ose nuk është në dispozicion ose nuk është i kompletuar.

2. Në rast se vazhdon mospërputhshmëria e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar ose ndaluar vënien në dispozicion në treg të produktit të ndërtimit ose sigurojnë që ai të rikthehet ose tërhiqet nga tregu.

KAPITULLI VIII**AKTET E DELEGUARA****Neni 50****Aktet e deleguara**

1. Me qëllim të arritjes së objektivave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë largimin dhe shmangien e kufizimeve për vënien e produkteve të ndërtimit në dispozicion në treg, çështjet e mëposhtme i delegohen Ministrisë në përputhje me nenin 52 dhe u nënshtrohet kushteve të përcaktuara në nenin 53 dhe 54 të këtij ligji:

1.1. kur është i përshtatshëm, përcaktimi i karakteristikave themelore ose i niveleve të pragut brenda grupeve specifike të produkteve të ndërtimit, për të cilat prodhuesi në përputhje me nenet 4 deri në 7 të këtij ligji e deklaron performancën e produktit me anë të niveleve apo klasave ose me përshkrim sa i përket qëllimit të përdorimit të tyre, kur ai vendoset në treg;

1.2. ndryshimi i periudhës për të cilën prodhuesi e ruan dokumentacionin teknik dhe deklaratën e performancës pas vendosjes së produktit të ndërtimit në treg, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji, në bazë të jetëgjatësisë së pritur të produkti i ndërtimit ose rolit që luan ai produkt në punimet e ndërtimit;

1.3. përcaktimi dhe përshtatja e klasave të performancës si përgjigje ndaj progresit teknik, në përputhje me nenin 24 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.4. kushtet në bazë të të cilave një produkt i ndërtimit konsiderohet të ketë përmbushur një nivel ose klasë të caktuar të performancës pa testim ose pa testim të mëtjeshëm në përputhje me nenin 24 paragrafi 4 të këtij ligji, me kusht që të mos rrezikohet përmbushja e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit;

1.5. përshtatja, krijimi dhe rishikimi i sistemeve të vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës në përputhje me nenin 24 të këtij ligji, në lidhje me një produkt të caktuar, një grup të caktuar produktesh ose karakteristikat themelore të dhëna, dhe në përputhje me:

1.5.1. rëndësinë e rolit që luan produkti ose ato karakteristika themelore në raport me kërkesat themelore për punimet e ndërtimit;

1.5.2. natyrën e produktit;

1.5.3. efektin e ndryshueshmërisë së karakteristikave themelore të produktit të ndërtimit gjatë jetëgjatësisë së pritur të produktit; dhe

1.5.4. ndjeshmërinë ndaj defekteve në prodhimin e produktit.

2. Gjatë propozimit të akteve të deleguara, Ministria merr parasysh aktet ekuivalente të deleguara të marra nga Komisioni Evropian.

3. Aktet e deleguara zbatohen për produktet të cilat i nënshtrohen shënimit CE ose shenjës së konformitetit të Kosovës në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dhe mund të zbatohen tek produktet e tjera të ndërtimit.

Neni 51

Aktet tjera të deleguara dhe aktet nënligjore

1. Ministria nxjerr akte tjera të deleguara dhe akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji kur të janë të nevojshme, ose mund t'u referohen dispozitave ekzistuese ligjore dhe/ose dispozitave nënligjore të Kosovës.

2. Çdo vendim i Ministrisë për të bërë të detyrueshëm përdorimin e shenjës së konformitetit të Kosovës do të lejojë përdorimin e shenjave të tjera rregulluese të konformitetit në mënyrë të barabartë në kërkesat e tyre teknike me ato të shenjës së konformitetit të Kosovës.

Neni 52

Ushtrimi i të drejtës për delegim

1. Ministria është kompetente për të miratuar aktet e deleguara sipas nenit 50 të këtij ligji për një periudhë prej pesë (5) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ministria do të përgatisë një raport në lidhje me kompetencën e deleguar të paktën gjashtë (6) muaj para përfundimit të periudhës pesë (5) vjeçare. Delegimi i kompetencës vazhdohet në mënyrë automatike për periudhat me kohëzgjatje identike, përveç nëse Qeveria e Kosovës e revokon atë në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.

2. Pasi të miratojë aktin e deleguar, Ministria e njofton Qeverinë e Kosovës dhe e publikon aktin.

3. Kompetenca për të miratuar aktet e deleguara i është dhënë Ministrisë dhe u nënshtrohet kushteve të përcaktuara në nenet 53 dhe 54 të këtij ligji.

Neni 53

Revokimi i delegimit

1. Delegimi i kompetencës të referuar në nenin 50 të këtij ligji mund të revokohet në çdo kohë nga Qeveria e Kosovës.

2. Kur Qeveria Kosovës të ketë filluar procedurën e brendshme për të vendosur nëse do ta revokojë delegimin e kompetencës, do të a informojë Ministrinë brenda një kohe të arsyeshme para marrjes së vendimit përfundimtar, duke treguar kompetencën e deleguar e cila mund të revokohet si dhe arsytet për mundshme për revokim.

3. Vendimi mbi revokimin i jep fund delegimit të kompetencës të përcaktuar në atë vendim. dhe hyn në fuqi menjëherë ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në atë dokument. Kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e akteve të deleguara që tashmë janë në fuqi.

Neni 54

Kundërshtimet ndaj akteve të deleguara

1. Qeveria e Kosovës mund të kundërshtojë aktin e deleguar brenda një periudhe prej tre (3) muajsh nga data e njoftimit. Kjo periudhë mund të zgjatet edhe për tre (3) muaj, me kërkesën e Qeverisë.

2. Nëse pas kalimit të periudhës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Qeveria e Kosovës nuk e kundërshton aktin e deleguar, ai publikohet dhe hyn në fuqi në datën e përcaktuar në dokument. Akti i deleguar mund të publikohet dhe të hyjë në fuqi para kësaj periudhe, nëse Qeveria e Kosovës e informon Ministrinë që nuk do të ngrit kundërshtim.

KAPITULLI IX

PRODUKTET E NDËRTIMIT QË NUK BARTIN SHENJËN E KONFORMITETIT

Neni 55

Produktet e ndërtimit që nuk bartin shenjën e konformitetit CE dhe shenjën e konformitetit të Kosovës

1. Të gjitha produktet e ndërtimit të vendosura në tregun e Kosovës, përveç atyre përputhshmëria e të cilëve me këtë ligj dëshmohet me anë të shenjës CE apo shenjës së konformitetit të Kosovës, do të jenë të një natyre të përshtatshme dhe në nivelin e duhur të performancës për të lejuar përfshirjen në punimet e ndërtimit të cilat të plotësojnë kërkesat rregullative. Duhet të dihet mundësia e produkteve të tilla për të performuar në mënyrë të përshtatshme dhe/ose nivelet e tyre specifike të performancës në raport me karakteristikat përkatëse themelore.

2. Natyra dhe/ose performanca e produkteve të tilla do të vlerësohet dhe deklarohet në përputhje me një nga pikat e mëposhtme:

- 2.1. një standard ndërkombëtar të përgatitur nga ISO ose IEC,
- 2.2. një standard rajonal të një zone të tregtisë së lirë,
- 2.3. një standard kombëtar të Kosovës,
- 2.4. një standard kombëtar të ndonjë shteti tjetër,
- 2.5. një skemë e pavarur për certifikimin e produktit të Kosovës ose ndonjë vendi tjetër, duke përfshirë produktet që janë në përputhshmëri me një vlerësim/miratim teknik ose ekuivalent,
- 2.6. testet, llogaritjet ose mjetet e tjera me të cilat mund të konstatohet përputhshmëria e produktit,
- 2.7. përvoja e kaluar, përdorimi i kënaqshëm në një ndërtesë ose punime të tjera të ndërtimit, ku përvoja e tillë lejon njohjen e përshtatshmërisë së produktit.

3. Kur mënyrat e vlerësimit të produkteve varen nga specifikimet e vendeve të tjera përveç Kosovës, dokumentet e konformitetit dhe nëse është e aplikueshme, shenjat e konformitetit duhet të vlerësohen në bazë të dispozitave në fuqi për pranimin e dokumenteve të konformitetit dhe shenjave të konformitetit.

4. Ministria me anë të akteve të deleguara sipas nenit 50 të këtij ligji mund të përcaktojë kushtet specifike në lidhje me vendosjen e produkteve në treg që mbulohen nga ky kapitull. Këto kushte përfshijnë karakteristikën ose karakteristikat që duhet të deklarohen, nevojën për të hartuar një deklaratë të performancës, si dhe sistemin ose sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës (Assessment of Verification Constancy of Performance) të cilët zbatohen për produktin. Këto kushte janë të detyrueshme.

5. Kur publikohen aktet e deleguara sipas paragrafit 4 të këtij neni, Ministria përcakton nëse aktet e tilla zbatohen vetëm për produktet sipas këtij neni apo nëse ato zbatohen edhe për produktet e ndërtimit të mbuluara nga shenja e konformitetit të Kosovës dhe/ose shenjën e konformitetit të Kosovës.

6. Përveç nëse specifikohet ndryshe në një akt të deleguar, sistemi i vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) i zbatueshëm për produktet e përcaktuara në këtë kapitull është sistemi 4 i cili përcaktohet me akt nënligjor në bazë të këtij ligji. Megjithatë, kjo nuk pengon vendosjen në tregun e Kosovës të produkteve në bazë të sistemit të vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) (ose ekuivalente) më të larta se sistemi 4.

7. Me vendosjen në tregun e Kosovës të produkteve të ndërtimit të përcaktuara nga ky kapitull, prodhuesi duhet të deklaron bazën mbi të cilën është vlerësuar natyra dhe përshtatshmëria e produktit, së bashku me çdo informacion të kërkuar nga specifikimet teknike të zbatueshme dhe/ose informacion të kërkuar me akte të deleguara sipas paragrafit 4 të këtij neni.

8. Në tregun e Kosovës kur do që vertetohet apo ankohen prodhuesit vendor të produkteve ndertimore, se po importohen produkte ndertimore nën koston e prodhimit vendor, Ministri me vendim mund të ndërmarr masa mbrojtëse në këtë fushë për ato produkte, duke mos shkelur apo keqpërdorur parimet e ekonomisë së lirë të tregut, MSA-në apo të CEFTA-së.

KAPITULLI X DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 56

Shkeljet për vendosjen në treg të produkteve të ndërtimit

1. Personi juridik i cili i ka prodhuar dhe i ka venë në dispozicion të tregut produktet e ndërtimit të cilat mbulohen nga standardet e harmonizuara ose që janë në përputhje me vlerësimin teknik të lëshuar për atë produkt, do të jetë përgjegjës nëse:

1.1. produkti nuk ka të vendosur shenjen e CE ose shenjen e konformitetit të Kosovës në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 ose nenin 10 paragrafi 2 deri 6 apo neni 11 të këtij ligji;

1.2. dispozitat e nenit 55 të këtij ligji nuk janë përmbushur;

1.3. një produkt i nënshtrohet një ose me shumë shmangieve nga neni 5 i këtij ligji.

2. Personi juridik ndëshkohet me gjobë në vlerë prej pesëmijë (5,000.00) deri pesëmbëdhjetë mijë euro (15,000.00 €), kur vërtetohen shkeljet e përcaktuara në nenin paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni.

3. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik ndëshkohet me gjobë në vlerë prej katërqind (400.00) deri një mijë euro (1,000.00 €), kur vërtetohen shkeljet e përcaktuara në nenin paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni.

Neni 57

Shkeljet e detyrimeve nga ana e operatorëve ekonomik

1. Operatorët ekonomik janë përgjegjës nëse kanë vepruar si në vijim:

1.1. prodhuesi i cili nuk i ka përmbushur cilëndo kërkesë nga neni 14 paragrafi 10 të këtij ligji;

1.2. importuesi i cili dështon të plotësoj cilëndo kërkesë të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 16 të këtij ligji;

1.3. importuesi i cili dështon të plotësoj cilëndo kërkesë të përcaktuar në nenin 16 paragrafin 7 të këtij ligji;

1.4. distributori i cili dështon të plotësoj cilëndo kërkesë të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 17 të këtij ligji; dhe

1.5. distributori i cili dështon të plotësoj cilëndo kërkesë të përcaktuar në nenin 17 paragrafi 4 të këtij ligji;

2. Operatorët ekonomik ndëshkohet me gjobë prej tremijë (3,000.00) deri pesëmijë euro (5,000.00) euro, kur vërtetohen shkeljet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik ndëshkohet me gjobë prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) deri tetëqind euro (800.00) euro kur vërtetohen shkeljet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 58 **Shkeljet e tjera**

1. Personi juridik i cili i ka prodhuar dhe i ka venë në dispozicion të tregut produktet e ndërtimit pa udhëzimet ose informacionet përkatëse si në vijim:

1.1. detyrimet e prodhuesit që të ofroj identifikimin e produktit sipas nenit 14 paragrafi 7 të këtij ligji;

1.2. detyrimet e prodhuesit që të ofroj informatat kontaktuese sipas nenit 14 paragrafi 8 të këtij ligji;

1.3. detyrimet e prodhuesit që të ofroj udhëzimet dhe informatat e sigurisë sipas nenit 14 paragrafi 9 të këtij ligji;

1.4. detyrimet e importuesit që të ofroj informatat kontaktuese sipas nenit 16 paragrafi 4 të këtij ligji;

1.5. detyrimet e importuesit që të ofroj udhëzimet dhe informatat e sigurisë sipas nenit 16 paragrafi 5 të këtij ligji;

1.6. detyrimet e distributorit sipas nenit 17 paragrafi 2 të këtij ligji;

1.7. rastet kur detyrimet e prodhuesit aplikohen edhe për importuesit dhe distributorët sipas nenit 18 të këtij ligji;

2. Personi juridik ndëshkohet me gjobe në vlerë prej tremijë (3,000.00) deri shtatë mijë euro (7,000.00) euro, kur vërtetohen shkeljet e përcaktuara në nën paragrafët 1.1 deri në 1.7 të këtij neni.

3. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik ndëshkohet me gjobë në vlerë prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) deri njëmijë euro (1,000.00) euro, kur vërtetohen shkeljet e përcaktuara në nën paragrafët 1.1 deri në 1.7 të këtij neni.

KAPITULLI XI **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 59 **Komiteti menaxhues**

1. Ministria mund të ndihmohet nga Komiteti Menaxhues për Ndërtim.

2. Anëtarët e këtij komiteti mund të përfshijnë përfaqësues të Ministrisë dhe agjencive të saj, të ministrive të tjera ose të organizatave të jashtme. Ministria sipas nevojës harton rregullat në lidhje me anëtarësimin dhe aktivitetet e këtij komiteti.

3. Ministria siguron që anëtarët e komitetit të jenë në gjendje të kryejnë funksionet e tyre në atë mënyrë që të shmangët konflikti i interesit, veçanërisht në lidhje me procedurat për marrjen e shenjës CE ose shenjen e konformitetit të Kosovës.

Neni 60

Shfuqizimi

Më hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 04/L-181 për Produktet e Ndërtimit dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të tij.

Neni 61

Dispozitat kalimtare

1. Produktet e ndërtimit të cilat vendosen në tregun e Kosovës me shenjën CE në përputhje me Rregulloren e BE-së 305/2011 (Rregullorja e Produkteve të Ndërtimit) do të konsiderohen se janë në përputhje me këtë ligj.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ministria vlerëson të gjitha standardet e miratuara si standarde të harmonizuara kosovare në mbështetje të këtij ligji dhe kur është e përshtatshme, vendos dhe publikon datat e reja për hyrjen në fuqi (kur bëhet i mundur shënjimi me shenjën e konformitetit të Kosovës) dhe datën e tërheqjes (kur shënjimi me shenjën e konformitetit të Kosovës bëhet i detyrueshëm dhe të gjitha specifikimet teknike të cilat janë në kundërshtim tërhiqen) të këtyre standardeve.

3. Ministria vazhdimisht monitoron gjendjen e zhvillimit të tregut për produktet e ndërtimit në Kosovë. Në rastet kur pas diskutimeve me prodhuesit, importuesit, trupat e vlerësimit të konformitetit dhe palët e tjera të interesuara të Kosovës, Ministria vendos se është e përshtatshme të tërheqë mundësinë e vendosjes së produkteve në tregun e Kosovës, në përputhje me dispozitat e nenit 55 të këtij ligji, dhe/ose me shenjën konformitetit të Kosovës, për një ose më shumë produkte ose grupeve të produkteve, ajo publikon këtë vendim.

4. Çdo vendim i publikuar duhet të shoqërohet me datat e periudhës kalimtare gjatë së cilës dispozitat që do të tërhiqen mund të ekzistojnë paralelisht me atë dispozitë apo dispozita të mbetura, dhe data pas së cilës vetëm dispozita/dispozitat e mbetura bëhen të detyrueshme.

5. Pa paragjykuar paragrafin 2 të nenit 37 të këtij ligji, që një trup të jetë i emëruar për të kryer detyra si palë e tretë nuk është i obliguar të paraqes certifikatën e akreditimit në aplikimin për në fushën për të cilën kërkon emërim për një periudhë prej dy (2) viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

6. Në rastin e referuar në paragrafin 5 të këtij neni, kur trupa nuk mund të ofroj certifikatën e akreditimit, atëherë ai duhet t'i ofrojë autoritetit emërues të gjitha dëshmitë e dokumentuara të nevojshme për verifikim, njohje të kompetencës dhe monitorim të rregullt të përputhshmërisë së tij me kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji. Vendimi për emërim duhet të ketë afat të caktuar kohor jo më të gjatë se dy (2) vite.

Neni 62

Raportimi nga Ministria

1. Ministria vlerëson nevojën specifike për informim mbi përmbajtjen e substancave të rrezikshme në produktet e ndërtimit dhe merr parasysh zgjerimin e mundshëm të detyrimit për informim për substancat tjera të përcaktuara në nenin 7 paragrafi 5 të këtij ligji dhe raporton në Qeverinë e Kosovës. Ndër të tjera, në vlerësimin e saj, Ministria merr parasysh nevojën për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve në përdorimin e produkteve të ndërtimit dhe të përdoruesve të punimeve të ndërtimit, duke përfshirë kërkesat

për riciklimin dhe/ose ripërdorimin e pjesëve ose materialeve. Në vlerësimin e saj, Ministria merr parasysh çdo vendim të marrë nga Komisioni Evropian për këtë çështje.

2.Nëse është e nevojshme, brenda dy (2) viteve pas dorëzimit të raportit sipas paragrafit 1 të këtij neni në Qeverinë e Kosovës, ky raport duhet të plotësohet me propozimet legjislative adekuate.

3. Brenda tri (3) viteve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria i paraqet Qeverisë së Kosovës një raport mbi zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë edhe nenin 23 dhe 24 të këtij ligji dhe vlerësimet teknike të Kosovës nëse është e nevojshme, në bazë të raporteve të ofruara nga të gjithë aktorët relevantë, të shoqëruar me propozimet e duhura, kur është e nevojshme.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -033
07 nëntor 2018

Shpallur me dekretin Nr. DL-057-2018, datë 23.11.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi